



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
OPSTINA SUVA REKA / MUNICIPALITY OF SUHAREKE
ZYRA E PROKURIMIT
PROCUREMENT OFFICE

Nr: 010/2022

Nr. Protokolli: 27/2022

Date: 16.06.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashkrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës: **14.06.2022**, të parashtruar nga Operatoret Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik AR - TECH SH.P.K.; Lulzim Eq. Gashi B.I., Brigada 123, 23000, Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore (Kanal i Hapur), Samadraxhë, Reshtan-Studençan**, me Nr. të Prokurimi: **624-22-3815-521 & 624- 22 060 521** nxjerr këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 14.06.2021, e parashtruar nga Operatoret Ekonomik:: Grup i Operatorëve Ekonomik AR - TECH SH.P.K.; Lulzim Eq. Gashi B.I., Brigada 123, 23000, Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore (Kanal i Hapur), Samadraxhë, Reshtan-Studençan**, me Nr. të Prokurimi: **624-22-3815-521 & 624- 22 060 521**, kundër Njoftim për Vendimin e AK -së, të datës **09.06.2022** të publikuar në platformen elektronike.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 09.06.2022.**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë: **14.06.2022**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit: **Ndërtimi i sistemit të ujitjes për siperfaqet bujqësore (Kanal i Hapur), Samadraxhë, Reshtan-Studençan**, me Nr. të Prokurimi: **624-22-3815-521 & 624- 22 060 521**, kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të dates, 09.06.2022, të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë sepse:

Për tu konsideruar një tender jo normalishtë I ulët duhe të plotësohen kushtet të cilat parashihen në “Rregullat per Tenderet Jo-Normalisht te Ulet:

Konform nenit 3 të këtyre rregullave nuk është plotësuar pika “i”, në mënyrë që AK ta konsiderojë ofertën e OE jo normalishtë të ulët i cili nen e specifikon në këtë formë ofertën jo normalishtë të ulët:

Neni 3 Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të **gjitha kushtet e mëposhtme:**

- i. çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;**
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;**
- iii. janë dorëzuar të paktën **3 (tre) tenderë.**

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Shef i Zyrës së Prokurimit
Bujar Kuçi

